

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Profilin Mësimor**

**TEKNIKË PESHKIMI**

**(Niveli III i KSHK)**  
**(1 vjeçar)**

**(Në drejtimin mësimor “DETARI”)**

**Kodi: J2-III-20**

Miratoi:

MINISTRI

.....

**Tiranë, 2020**

## **Përmbajtja:**

**I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit “Detari”.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Detari”.**

1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK.

**III. Plani mësimor për profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Detari”.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor.**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Detari”.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Detari”.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Detari”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me teknikat e peshkimit. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:*

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Detari”.**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Teknikë peshkimi” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Detari”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale e rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK.**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale të sektorit të furnizim/mirëmbajtje të teknikës së peshkimit.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të sektorit të furnizim/mirëmbajtje të teknikës së peshkimit.
- Të bëjë organizimin e vogël të punës në proceset e përgatitjes teknike për lundrimin e anijes për qëllime peshkimi;
- Të dallojë formën e lëvizjen e tokës, pikat dhe rrathët kryesore, koordinatat gjeografike;
- Të përshkruajë veçoritë e magnetizmit tokësor, busullën magnetike, ndikimi i saj mbi anije;
- Të llogarisë korigjimin dhe kthimin e kurseve dhe pelengjeve;
- Të përshkruajë projeksionin hartografik, shkallën, leximin e shtrimin grafik të lundrimit;
- Të përshkruajë metodat e përcaktimit të vendodhjes së anijes në det;
- Të dallojë veçoritë e erërave dhe rrymës detare dhe ndikimi i tyre tek anija në lundrim;
- Të përshkruajë dokumentacionin e anijes së peshkimit para lundrimit për gjueti peshku;
- Të përshkruajë veçoritë e lundrimit të anijes në rrethana të veçanta si kanale, ngushtica etj;
- Të përshkruajë veçoritë e një feneri të caktuar detar nga karakteristikat e tij;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e paisjeve navigacionale si Radari, xhirobusulla, autopiloti, GPS, eholloti, sonari, navtex, Blue Box-it, etj. në anije;
- Të përshkruajë parimet, normat dhe aktorët e përfshirë në komunikim sipas Sistemit Global të Komunikimit për Rreziqet dhe Sigurinë në Det;
- Të përshkruajë hapat e punës për ndezjen dhe fikjen e agregateve të instaluar;
- Të përshkruajë hapat e punës për shërbime të valvolave, saraçineskave, tubacioneve, etj.;
- Të përshkruajë hapat e punës për punime në hapësira të mbyllura;
- Të përshkruajë masat e sigurisë për punime/furnizime/transferime në lokalitete të makinërisë;
- Të përshkruajë markimet e sistemeve dhe agregateve të instaluar në anije;
- Të interpretojë faktorët që ndikojnë në kapshmërinë e veglës peshkore;
- Të interpretojë gjeometrinë e rrjetës;
- Të interpretojë paraqitjen skematike, shenjat dhe simbolet e një vegle peshkimi;
- Të rendisë materialet që përdoren ndërtimin e vegle peshkimi;
- Të llogarisë forcat e jashtme ndikuese mbi veglën e peshkimit stacionare dhe në lëvizje;

- Të llogarisë rezistencën që i paraqet vegla e peshkimit mjedisit ujor;
- Të përshkruajë parimet kryesore të ndërtimit dhe gjuetisë së veglave të peshkimit;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore me syzëpërfshirje;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi me syzëpërfshirje;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore pasive;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi pasive;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore rrethuese të hapura;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi rrethuese të hapura;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore rrethuese të mbyllura;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi rrethuese të mbyllura;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore rrethore;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi rrethore;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore stacionare;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi stacionare;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore fundore dhe mesujore;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi fundore dhe mesjore;
- Të përshkruajë hapat e punës për gjuetinë me trata fundore dhe mesujore të tipeve të ndryshme;
- Të kryejë riparime të thjeshta të veglave të gjuetisë të dëmtuara nga gjuetia në anije;
- Të zbatoje standartet e sigurisë dhe shëndetit në punë në anije gjatë lundrimit, gjuetisë, punës në temperatura mjaft të ulta dhe për riparimin e veglave të dëmtuara nga gjuetia;
- Të marrë pjesë aktive në ndërtimin e një vegle peshkimi me syzëpërfshirje;
- Të përshkruajë parimet e gjuetisë, hapat e punës dhe rregullat e FAO-s për gjuetinë e tonit;
- Të përshkruajë hapat e punës dhe kufizimet në gjuetinë e midhjeve dyguaskore;
- Të rendisë rregullat dhe metodat vrojtimit të peshkut;
- Të përshkruajë masat e sigurisë në punë, normat e higjienës, veprimet në kuvertë për hedhjen e veglës së gjuetisë në ujë dhe marjen e saj nga uji;
- Të përshkruajë aspekte të legjislacionit dhe monitorimit detar që lidhet me peshkimin;
- Të përshkruajë parimet dhe hapat e punës për sistemimin dhe ruajtjen e produkteve nga gjuetia;
- Të dallojë peshqit normalë, të sëmurë, të helmuar, traumatizuar, asfiksuar dhe atrofizuar;
- Të marrë masa për shmangie sëmundjesh, helmimi, traumatizimi, asfiksie dhe atrofizimi tek peshqit;
- Të jetë pjesë aktive për fekondimin artificial të peshqve;
- Të përgatisë ushqimin dhe ushqejë larvat dhe rasatet;
- Të bashkëpunojë në kultimin artificial të peshqve në pellgje dhe bregdet;
- Të vlerësojë, me sy të lirë, përqendrimet e planktonit, fito- dhe zooplanktonit në ujë;
- Të masë elementët ndikues të nivelit të oksigjenit dhe dioksidit të karbonit në ujra;
- Të përshkruajë vetitë fiziko kimike të ujërave dhe ndikimet e tyre në gjallesat ujore;
- Të përshkruajë parimet dhe shtresat e përhapjes së dritës në ujëra;

#### **4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK.**

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me çertifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës në cilësinë e:

- specialistit të teknikës së peshkimit;
- rjetapunuesit – mirëmbajtës - riparuesit;
- ndihmës kultivues peshku;

Mbas një përvojë lundrimi në sektorin e peshkimit prej 6 muajsh në kuvertë dhe/ose po kaq në makineri, i lind e drejta e testimit para Drejtorisë së Përgjithshme Detare për t'u paisur me Çertifikatën e Kompetencës sipas Rregullit IV/1 të Konventës STCF-'95<sup>i</sup> në cilësitë e:

- peshkatarit të kualifikuar në anije peshkimi deri në 24 metra gjatësi, dhe/ose
- motoristit në anije peshkimi me fuqi motorike deri në 750 kW,

Dhe/ose mbas një përvojë lundrimi në mjetet lundruese të flotës tregtare prej 6 muajsh në kuvertë dhe/ose po kaq në sektorin e makinerisë, i lind e drejta e testimit para Drejtorisë së Përgjithshme Detare për t'u pajisur me Çertifikatën e Kompetencës sipas Rregullit II/4 dhe/ose III/4 të Konventës së STCW-'78<sup>ii</sup> e ndryshuar (Ligji Nr. 8569 datë 20.01.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare" dhe "Për standardet e kualifikimit, atestimit dhe të shërbimit për detarët", e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nga IMO (Organizata Ndërkombëtare Detare).

Me përfundimin e kualifikimit në këtë nivel, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV (teknik/manaxherial) të kualifikimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin "Detari", për të fituar diplomën e "Maturës shtetërore profesionale", me mundësi për vazhdimin e studimeve të larta universitare ose pas të mesmes.

### III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin "Teknikë peshkimi", niveli III i KSHK, të drejtimit "Detari".

<b>Plani mësimor për profilin mësimor "Teknikë peshkimi", niveli III i KSHK</b>			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët
			javore/ vjetore
			<b>Klasa 12</b>
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme</b> (Gjithsej)	<b>8/9</b> (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale</b> (Gjithsej)	<b>7 (238)</b>
1	L-17-157-20	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-16-540-20	Teknikë peshkimi	3
3	L-30-541-20	Lundrim	1
4	L-16-542-20	Akuakulturë	1
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale</b> (Gjithsej)	<b>12 (408)</b>
1	M-16-1675-20	Teknika peshkimit me syzëpërfshirje	135
2	M-16-1676-20	Teknika peshkimit tip grackë rrethore	102
3	M-16-1677-20	Lundrim dhe peshkim	102
4	M-16-1678-20	Rritje artificiale e peshqve	69

D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-16-1679-20	Shërbime në veglat e peshkimit	102
2	M-16-1680-20	Teknika peshkimit tip tratë krahu	102
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>30/31</b> (1020/ 1054)

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

#### V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxënësi, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar

*kompetencat kyçe, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi. Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Teknikë peshkimi”. Instruktori i praktikës profesionale duhet të udhëhiqet nga kërkesat e legjislacionit, Udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe në parimet e praktikës së sigurtë të punës në det. Për këtë, duhet ti referohet citimeve përkatëse të legjislacionit si vijon:*

## **LIGJ Nr.9251, date 8.7.2004 KODI DETAR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

### **Neni 101**

#### **Nxënësit dhe praktikantët**

1. Kapitani mund të pranojë në mjetin lundrues, me leje të pronarit dhe me miratimin e kapitanerisë së portit ku ka qendrën, nxënës të shkollave detare dhe praktikantë të profesioneve detare, të cilët mund të kryejnë detyra vetëm në prani të anëtarit të ekuipazhit që ka dëshminë përkatëse.
2. Në mjetet lundruese të transportit të udhëtarëve, nxënësit dhe praktikantët mund të jenë vetëm vëzhgues të veprimeve.
3. Nxënësit ose praktikantët, që janë në mjetin lundrues gjatë lundrimit, konsiderohen pjesëtarë të ekuipazhit, me dallimet përkatëse në paga.

Në përputhje me Ligjin Nr. 10109 datë 10.2.2009 “Për Administratën Detare në Republikën e Shqipërisë”, Shkolla profesionale duhet të bashkërendojë veprimtaritë përkatëse praktike dhe të testimit me Drejtorinë e Përgjithshme Detare për procesin e kualifikimit të nxënësve të drejtimit mësimor “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK.

#### **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar.

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e detarisë dhe peshkimit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.



## **VII. Të dhëna për çertifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Detari”.**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Teknikë peshkimi”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli.

Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
  - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale, modulet profesionale dhe praktikën profesionale të grupuar, për çdo vit shkollor;
  - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III të KSHK;

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-20). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë mërrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

<b>Tema 1</b>	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
<b>Tema 2</b>	Aftësitë dhe sjellja sipërmarrëse	3 orë
<b>Tema 3</b>	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
<b>Tema 4</b>	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	4 orë
<b>Tema 5</b>	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
<b>Tema 6</b>	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë
<b>Tema 7</b>	Etika e komunikimit dhe negocimit	4 orë

<b>Tema 8</b>	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
<b>Tema 9</b>	Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
<b>Tema 10</b>	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
<b>Tema 11</b>	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
<b>Tema 12</b>	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
<b>Tema 13</b>	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	5 orë
<b>Tema 14</b>	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
<b>Tema 15</b>	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
<b>Tema 16</b>	Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.	6 orë
<b>Tema 17</b>	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	5 orë
<b>Tema 18</b>	Marrëdhëniet e punës	4 orë

## 2. Lënda “Teknikë peshkimi” (L-16-540-20). Kl. 12 - 102 orë

### • Synimet e lëndës “Teknikë peshkimi”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknikë peshkimi”, klasa 12, nxënësi duhet:

- Të interpretojë përzgjedhjen dhe kapshmërinë e peshkut nga një vegël peshkimi në raport me madhësinë e syzës, diametrin e fijos, lëshueshmërinë apo ngjyrën e rrjetës;
- Të interpretojë gjeometrinë e rrjetës;
- Të interpretojë paraqitjen skematike, shenjat dhe simbolet e një vegle peshkimi;
- Të rendisë materialet që përdoren ndërtimin e vegle peshkimi;
- Të llogarisë forcat e jashtme ndikuese mbi veglën e peshkimit stacionare dhe në lëvizje;
- Të llogarisë rezistencën që i paraqet vegla e peshkimit mjedisit ujor;
- Të përshkruajë parimet kryesore të ndërtimit dhe gjuetisë së veglave të peshkimit;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore me syzëpërfshirje;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi me syzëpërfshirje;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore pasive;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi pasive;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore rrethuese të hapura;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi rrethuese të hapura;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore rrethuese të mbyllura;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi rrethuese të mbyllura;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore rrethore;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi rrethore;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore stacionare;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi stacionare;
- Të interpretojë parimet e ndërtimit dhe gjuetisë së veglave peshkore fundore dhe mesujore;
- Të llogarisë materialet për ndërtimin e një vegle peshkimi fundore dhe mesujore;
- Të përshkruajë hapat e punës për gjuetinë me trata kiçi tradicionale;
- Të përshkruajë hapat e punës për gjuetinë me trata binjake (pellagjike);
- Të përshkruajë hapat e punës për gjuetinë me trata kiçi të tipit francez, italian dhe amerikan;
- Të përshkruajë parimet e gjuetisë, hapat e punës dhe rregullat e FAO-s për gjuetinë e tonit;
- Të përshkruajë hapat e punës dhe kufizimet ligjore për gjuetinë e midhjeve dyguaskore;
- Të rendisë rregullat dhe metodat vrojtimit të peshkut;

- Të përshkruajë masat e sigurisë në punë, normat e higjenës, veprimet në kuvertë për hedhjen e veglës së gjuetisë në ujë dhe marjen e saj nga uji;
- Të përshkruajë aspekte të legjislacionit dhe monitorimit detar që lidhet me peshkimin;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknikë peshkimi”, kl.12- 102 orë**

<b>Tema 1</b>	Përzgjedhja dhe kapshmëria e peshkut në një vegël peshkimi;	5 orë
<b>Tema 2</b>	Gjeometria e rrjetës;	4 orë
<b>Tema 3</b>	Paraqitja skematike, shenjat dhe simbolet e veglave të peshkimit;	3 orë
<b>Tema 4</b>	Materialet dhe masa e tyre në një vegël peshkimit;	6 orë
<b>Tema 5</b>	Forcat vepruese në veglat e peshkimit. Njësimi i rezistencës;	6 orë
<b>Tema 6</b>	Parimet kryesore të ndërtimit dhe gjuetisë së veglave të peshkimit;	2 orë
<b>Tema 7</b>	Ndërtimi i veglave peshkore syzëpërfshirëse dhe teknika e gjuetisë;	7 orë
<b>Tema 8</b>	Ndërtimi i veglave të peshkimit pasiv dhe teknika e gjuetisë;	7 orë
<b>Tema 9</b>	Ndërtimi i veglave rrethuese të hapura dhe teknika e gjuetisë;	7 orë
<b>Tema 10</b>	Ndërtimi i veglave rrethuese të mbyllura dhe teknika e gjuetisë;	7 orë
<b>Tema 11</b>	Ndërtimi i veglave peshkore rrethore dhe teknika e gjuetisë;	4 orë
<b>Tema 12</b>	Ndërtimi i veglave peshkore stacionare dhe teknika e gjuetisë;	7 orë
<b>Tema 13</b>	Ndërtimi dhe puna e veglave të peshkimit fundor dhe mesujor;	8 orë
<b>Tema 14</b>	Teknika e peshkimit me trata kiçi tradicionale;	4 orë
<b>Tema 15</b>	Teknika e peshkimit me trata binjake (pellagjike);	4 orë
<b>Tema 16</b>	Teknika e peshkimit me tratat e tipit francez, italian, amerikan etj.;	5 orë
<b>Tema 17</b>	Teknika e peshkimit të peshkut ton. Rregullat e FAO-s;	3 orë
<b>Tema 18</b>	Veglat e gjuetisë së midhjeve dyguaskore dhe teknika e gjuetisë;	3 orë
<b>Tema 19</b>	Rregullat dhe metodat e vrojtimit të peshkut;	2 orë
<b>Tema 20</b>	Problemet dhe reagimet gjatë gjuetisë me veglën në ujë;	2 orë
<b>Tema 21</b>	Masat e sigurisë në punë, higjenike dhe operacionale për hedhjen në ujë dhe marjen nga uji të veglës së gjuetisë.	3 orë
<b>Tema 22</b>	Aspekte të legjislacionit dhe monitorimit detar në peshkim.	3 orë

**3. Lënda “Lundrim” (L-30-541-20). Kl. 12 – 34 orë**

• **Synimet e lëndës “Lundrim”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Lundrim”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të dallojë formën dhe lëvizjen e tokës, pikat dhe rrathët kryesore, koordinatat gjeografike në funksion të lundrimit;
- Të përshkruajë veçoritë e magnetizmit tokësor, busullën magnetike, ndikimi i saj mbi anije;
- Të llogarisë korigjimin dhe kthimin e kurseve dhe pelengjeve;
- Të masë madhësitë e ndryshme gjatësore që përdoren për matjen e largësive dhe thellësive në lundrim, si dhe aparatet matëse të tyre;
- Të përshkruajë projeksionet hartografike, shkallën e hartave, leximin e tyre, shtrimin grafik të lundrimit në hartë;
- Të përshkruajë metodat e përcaktimit të vendodhjes së anijes në det;
- Të dallojë veçoritë e erërave dhe rrymës detare dhe ndikimi i tyre tek anija në lundrim;
- Të përshkruajë dokumentacionin e anijes së peshkimit para lundrimit për gjueti peshku;
- Të përshkruajë veçoritë e lundrimit të anijes në rrethana të veçanta si kanale, ngushtica etj;
- Të listojë literaturën kryesore navigacionale në peshkim;

- Të përshkruajë veçoritë e një feneri të caktuar detar nga karakteristikat e tij;
- Të përshkruajë funksionet e treguesve të xhirove të motorrit, të lëvizjes dhe të drejtimit të anijes;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e paisjeve navigacionale si Radari, xhirobusulla, autopiloti, GPS, eholloti, sonari, navtex, Blue Box-it, etj. në anije;
- Të përshkruajë parimet dhe tiparet e shërbimeve të komunikimit të lëvizshëm detar;
- Të përshkruajë parimet e punës të Sistemit Global të Komunikimit për Rreziqet dhe Sigurinë në Det;
- Të përshkruajë legjislacionin, rregullat dhe institucionet përkatëse për komunikimin në det;
- Të përshkruajë hapat e punës për ndezjen dhe fikjen e moto-gjeneratorëve;
- Të përshkruajë hapat e punës për ndezjen dhe fikjen e agregateve të instaluar si pompa elektrike dhe/ose pompa hidraulike në funksion të shërbimeve në det;
- Të përshkruajë hapat e punës për ndezjen dhe fikjen e kompresorëve në funksion të mbushjes së bombolave të ajrit;
- Të përshkruajë hapat e punës për zmontimin dhe montimin e valvolave dhe saraçineskave;
- Të përshkruajë hapat e punës për zmontimin dhe montimin e tubacioneve të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat e punës në hapësira të mbyllura përfshirë hapjen dhe mbylljen e kapakëve;
- Të përshkruajë hapat e punës për eliminimin e rrjedhjeve nga tubacionet në anije;
- Të përshkruajë hapat e punës për zmontimin dhe montimin e panjollave në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë hapat e punës për dorëzimin tek impiantet marrëse portuale të mbeturinave hidro-karbure në anijes si sentina, llumra nga separatori, vaji i djegur, etj.
- Të përshkruajë masat e sigurisë për punime saldimi në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë hapat e punës për marjen e masave për furnizimin me karburant dhe ujë;
- Të përshkruajë markimet e sistemeve dhe agregateve të instaluar në anije;
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Lundrim”, kl. 12 - 34 orë:**

<b>Tema 1</b>	Forma dhe lëvizja e tokës, pikat dhe rrathët kryesore, koordinatat gjeografike në funksion të lundrimit	1 orë
<b>Tema 2</b>	Magnetizmi tokësor, busulla magnetike dhe ndikimi i saj mbi anije	1 orë
<b>Tema 3</b>	Korigjimi dhe kthimi i kurseve dhe pelengjeve	1 orë
<b>Tema 4</b>	Madhësitë e ndryshme gjatësore që përdoren për matjen e largësive dhe thellësive në lundrim, si dhe aparatet matëse të tyre	1 orë
<b>Tema 5</b>	Projeksionet hartografike, shkalla e hartave, leximi i tyre, shtrimi grafik i lundrimit në hartë	2 orë
<b>Tema 6</b>	Përcaktimi i vendodhjes së anijes në hartë	2 orë
<b>Tema 7</b>	Erërat dhe rrymat detare dhe ndikimi i tyre tek anija në lundrim	1 orë
<b>Tema 8</b>	Dokumentacioni i anijes para daljes për lundrim për gjueti peshku.	1 orë
<b>Tema 9</b>	Veçoritë e lundrimit në rrethana të veçanta si kanale, ngushtica etj.	1 orë
<b>Tema 10</b>	Literatura navigacionale në mjetin e peshkimit	1 orë
<b>Tema 11</b>	Fenerët detar, funksioni dhe karakteristikat;	1 orë
<b>Tema 12</b>	Treguesit e ndryshëm në urën e komandës dhe integrimi;	1 orë
<b>Tema 13</b>	Paisjet radio-navigacionale në urën e komandës;	2 orë
<b>Tema 14</b>	Parimet e përgjithshme dhe tiparet bazë të shërbimeve të komunikimit të lëvizshëm detar (IMO Model 1.26);	2 orë
<b>Tema 15</b>	Parimet e punës të Sistemit Global të Komunikimit për Rreziqet dhe Sigurinë në Det GMDSS;	2 orë
<b>Tema 16</b>	Rregullat dhe legjislacionin përkatës të komunikimit në det;	2 orë

<b>Tema 17</b>	Moto-gjeneratorët e instaluar në anije;	2 orë
<b>Tema 18</b>	Agregatet elektrike, hidraulike dhe pneumatike të instaluar;	1 orë
<b>Tema 19</b>	Kompresorët e ajrit. Funksioni, mirëmbajtja dhe puna me to;	1 orë
<b>Tema 20</b>	Tubacionet, valvolat dhe saraçineskat në lokalin e makinerisë;	1 orë
<b>Tema 21</b>	Tanket dhe depot e anijes. Hyrja dhe puna/inspektimi në to;	1 orë
<b>Tema 22</b>	Dyshemeja dhe sentinat në lokalin e makinerisë. Mirëmbajtja;	1 orë
<b>Tema 23</b>	Mbetjet hidrokarbure. Dorëzimi në impantet pritëse portuale;	2 orë
<b>Tema 24</b>	Masat e sigurisë para dhe pas kryerjes së punimeve/furnizimeve;	1 orë
<b>Tema 25</b>	Markimet në lokalin e makinerisë;	1 orë
<b>Tema 26</b>	Evidentimi i veprimtarisë në lokalin e makinerisë	1 orë

#### **4. Lënda “Akuakulturë” (L-16-542-20). Kl. 12 – 34 orë**

- **Synimet e lëndës “Akuakulturë”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Akuakulturë”, klasa 12, nxënësit duhet:

- Të dallojë individët e peshqve të helmuar, traumatizuar, asfiksuar dhe atrofizuar;
  - Të marrë masa profilaktike për shmangien e helmimit, traumatizimit, asfiksionit dhe atrofizimit të peshqve.
  - Të seleksionojë riprodhuesit që japin rendiment të lartë në bazë të shenjave përkatëse;
  - Të dallojë shenjat e afshit seksual të riprodhuesve të peshqve;
  - Të marrë masat për fekondimin artificial të peshqve;
  - Të hedhë vezët e fekunduara në inkubatorin e çeljes së larvave;
  - Të llogarisë kohën e çeljes në varësi të faktorëve si temperatura, shpejtësia e lëvizjes së ujit;
  - Të përgatisë ushqimin dhe ushqejë larvat;
  - Të përgatisë ushqimin dhe ushqejë rasatet;
  - Të jetë pjesë aktive në plehërimin e pellgut të riprodhuesve në kohën e duhur;
  - Të përdorë ushqimet koncentrate si dhe kombinacionet në recetat ushqimore;
  - Të përshkruajë strukturat e disa racave të përmirësuara në llojet e peshqve të kultivuar;
  - Të vlerësojë përqëndrimet e planktonit, fitoplanktonit dhe zooplanktonit;
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Akuakulturë”, kl. 12 - 34 orë:**

<b>Tema 1</b>	Helmimi, traumatizimi, asfiksia dhe atrofizimi i peshqve. Shenjat. Masat profilaktike;	4 orë
<b>Tema 2</b>	Seleksionimi i riprodhuesve;	2 orë
<b>Tema 3</b>	Afshi seksual i riprodhuesve të peshqve;	2 orë
<b>Tema 4</b>	Fekondimi artificial i peshqve;	4 orë
<b>Tema 5</b>	Hedhja e vezëve të fekunduara në inkubatorin e çeljes së larvave;	3 orë
<b>Tema 6</b>	Faktorët ndikues në kohën e çeljes së larvave;	3 orë
<b>Tema 7</b>	Transporti i larvave nga inkubatori deri në pellgun e larvave;	2 orë
<b>Tema 8</b>	Përgatitja dhe dhënia e ushqimit të larvave dhe rasateve;	3 orë
<b>Tema 9</b>	Plehrimi i pellgut të riprodhuesve;	2 orë
<b>Tema 10</b>	Ushqimet koncentrate si dhe kombinimet në recetat ushqimore;	4 orë
<b>Tema 11</b>	Struktura në racat e përmirësuara në llojet e peshqve të kultivuar;	3 orë
<b>Tema 12</b>	Përqëndrimi i planktonit, fitoplanktonit dhe zooplanktonit;	2 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Teknika e peshkimit me syzëpërfshirje”

**Drejtimi:** Detari  
**Profili:** Teknikë peshkimi  
**Niveli:** III i KSHK  
**Klasa:** 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	TEKNIKA E PESHKIMIT ME SYZËPËRFSHIRJE	M-16-1675-20
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që aftëson nxënësit të marrë pjesë aktive në projektimin e një vegje peshkimi me syzëpërfshirje me tre perde, në ndërtimin e saj dhe gjuetinë me të në bregdet.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	135 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Detari”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Nxënësi projektton një vegël peshkimi me 3 perde me syzëpërfshirje.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të skicojë veglën e peshkimit me syzëpërfshirje me 3 perde;</li><li>- të llogarisë madhësinë e syzës për perden bazë dhe perdet e jashtme;</li><li>- të llogarisë gjatësinë, ngjyrën dhe fijen e materialit rrjetor;</li><li>- të llogarisë fijen për qepje në litar;</li><li>- të llogarisë koeficientin e rremzhimit, lirshmërinë e qepjes në litar për të tre perdet;</li><li>- të llogarisë gjatësinë, diametrin dhe llojin e litarëve;</li><li>- të llogarisë sasinë dhe madhësinë e pluskueseve dhe peshave;</li><li>- të llogarisë peshën e përgjithshme të veglës së peshkimit;</li><li>- të përdorë shenjat dhe simbolet në projektim;</li><li>- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.</li><li>- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri.</li><li>- të mirëmbajë vendin e punës.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul>	

## **RM 2 Nxënësi ndërton veglën e peshkimi me 3 perde me syzëpërfshirje.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë materialet e ndërtimit sipas projektit, materialin rrjetor, litarët, pluskuesat, peshat dhe fijet në cilësi e lloj;
- të llogarisë sasinë e materialeve për përdorim sipas projektit;
- të përgatisë veglat dhe ambientet e punës ku do të ndërtohet vegla e peshkimit, drugën, statikët, ndriçimin, ajrosjen, etj.;
- të presë me thikë materialet e përzgjedhura sipas gjatësive të llogaritura përfshirë perdet e rrjetës dhe litarët;
- të bashkëpunojë hapjen dhe shtrirjen e materialeve për ndërtimin e veglës së peshkimit;
- të realizojë vendosjen e pluskuesave dhe peshave në litarët përkatës;
- të mbushë drugën me fijen e duhur;
- të përdorë drugën për qepjen e rrjetës në litar sipas koeficientit të remzhimit dhe raportit të lirshmërisë sipas projektit;
- të përdorë teknikën e duhur për kalimin dhe shtrëngimin e fijes në litar;
- të pozicionojë në vendin e duhur pluskuesat dhe peshat gjatë qepjes së matialit rrjetor në litar;
- të bëjë kontrole, herë pas here, në gjatësi të caktuara të qepjes, për deformime nga përpindikularja midis qepjes së materialit rrjetor në litarin e pluskuesave me atë të peshave;
- të qepë sipas koeficientit të caktuar në litarët e pluskuesave dhe atë të peshave, perdet e dyta dhe të treta të veglës;
- të vendosë pluskuesat dhe peshat fundore sipas projektit;
- të raportojë për përfundimin e punës;
- të interpretojë pritshmëritë peshkore nga vegla e përgatitur;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

## **RM 3 Nxënësi hedh për peshkim në bregdet veglën e përgatitur**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjedisin ku do të kryhet peshkimi;
- të vlerësojë motin e përshtatshëm për vozitje të qetë dhe peshkim;
- të përgatisë mjetet e punës;
- të përgatisë sanallin për vozitje;
- të vendosë veglën e peshkimit në sanall, larg pengesave në teneshirin e kështj;
- të vendosë mjetet vetjake të shpëtimit në sanall;
- të vendosë peshat në sanall;
- të vendosë si duhet pluskueset me shenjë ose dritë në sanall;



- të veshë kostumin prej mushamaje;
- të veshë xhaketën e shpëtimit;
- të vozisë, pa zhurmë, sanallin për në vendin e hedhjes së veglës së peshkimit;
- të lidhë si duhet peshën me fundin e veglës së peshkimit;
- të hedhë me kujdes peshën dhe pluskuesen e fundit në ujë së bashku me shenjën dhe/ose dritën;
- të hedhë pa ngatërruar veglën e peshkimit në ujë, ndërkohë që sanalli vozitet nga person tjetër;
- të lidhë si duhet peshën dhe pluskuesen me shenjë ose dritë tek fundit tjetër i veglës së peshkimit;
- të vazhdojë vozitjen si duhet, ndërkohë që hidhet vegla e peshkimit në ujë nga person tjetër;
- të vozisë me zhurma për të shkuar në skajin e parë ku u hodh vegla e peshkimit;
- të godasë filin e sanallit, me mjete të forta, për të krijuar zhurma;
- të marrë me kujdes pluskuesen dhe peshën e hedhur në fillim në sanall;
- të marrë, mbarë e pa ngatërruar, veglën e peshkimit në sanall;
- të heqë peshkun e rënë në veglën e peshkimit;
- të vendosë peshkun e zënë tek arka e mbledhjes së peshkut;
- të pastrojë mirë veglën e peshkimit nga papastërtitë;
- të stivojë, pa ngatërruar, veglën e peshkimit në teneshirin e sanallit;
- të marrë në sanall pluskuesen dhe peshën e hedhur në fund;
- të vozisë mbarë për të shkuar në breg;
- të nxjerrë në breg sanallin, duke e tërhequr;
- të vendosë, pa i dëmtuar, mjetet dhe pajimet që ndodhen në sanall tek vend ruajtja;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Nxënësi mbledh veglën e hedhur për peshkim në bregdet**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të llogarisë kohën e duhur për lënien e veglës në ujë për peshkim;
- të vlerësojë motin e përshtatshëm për vozitje të qetë për marjen e veglës nga uji;
- të përgatisë mjetet e punës;
- të përgatisë sanallin për vozitje;
- të pastrojë sanallin nga pengesa në vendin ku do vensosen peshat, pluskuesat, dritat, shenjat, peshku i zënë pas marjes nga uji të veglës së peshkimit;
- të vendosë mjetet vetjake të shpëtimit në sanall;

- të vendosë peshat në sanall;
- të veshë kostumin prej mushamaje;
- të veshë xhaketën e shpëtimit;
- të vozisë, pa zhurmë, sanallin për në vendit ku ka hedhur veglën e peshkimit;
- të marë me kujdes nga ujit peshën dhe pluskuesen e parë së bashku me shenjën dhe/ose dritën;
- të marë me kujdes dhe pa ngatërruar veglën e peshkimit nga ujë, ndërkohë që sanalli vozitet nga person tjetër;
- të heqë pa dëmtime peshkun e zënë në vegël;
- të vendosë peshkun e zënë tek arka e mbledhjes së peshkut;
- të stivojë në vendin e caktuar materialin rrjetor, peshat dhe pluskueset së bashku me shenjën dhe/ose dritën;
- të vazhdojë vozitja si duhet nga person tjetër deri në mbledhjen e peshës dhe pluskueses së fundit së bashku me dritën dhe/ose shenjën;
- të pastrojë mirë veglën e peshkimit nga papastërtitë;
- të vozisë mbarë për të shkuar në breg;
- të nxjerrë në breg sanallin, duke e tërhequr;
- të vendosë, pa i dëmtuar, mjetet dhe pajimet që ndodhen në sanall tek vend ruajtja;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul trajtohet në repartin e riparimit të rrjetave ose laborator shkollor të përshtatshëm dhe në bregdet.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve për projektimin, ndërtimin dhe realizimin e gjuetisë së peshkut me syzëpërfshirje, në bregdet.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për projektim, ndërtim dhe realizimin e gjuetisë me vegël peshkimi me syzëpërfshirje në bregdet.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, në projektimin, në ndërtimin dhe realizimin e gjuetisë së peshkut me syzëpërfshirje, në bregdet.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- laborator i përshtatshëm shkolle apo repart i riparimi të rrjetave;
  - materiale të nevojshme për ndërtimin e veglës së peshkimit me syzëpërfshirje me 3 perde përfshirë material rrjetor, litarë,
-

- 
- pluskuesa, pesha, fije, drugë, statikë etj.;
- sanall peshkimi me pajimet përkatëse të gjuetisë në bregdet
  - veshjet vetjake të mbijetesës si: rreth shpëtimi, xhaketë shpëtimi dhe kostum mushamaje pune;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për ndërtimin e veglës peshkore me syzëpërfshirje për gjueti në bregdet;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për kryerjen e gjuetisë me vegël peshkore me syzëpërfshirje për gjueti në bregdet;
  - mjetet e duhura për sistemimin e peshkur të kapur.
  - materiale të shkruara në mbështetje të realizimit të modulit
-

## 2. Moduli “Teknika e peshkimit tip grackë rrethore”

**Drejtimi:** Detari  
**Profili:** Teknikë peshkimi  
**Niveli:** III i KSHK  
**Klasa:** 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

<b>Titulli dhe kod</b>	<b>TEKNIKA E PESHKIMIT TIP GRACKË RRETHORE</b>	<b>M-16-1676-20</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që aftëson nxënësit të marrë pjesë aktive në projektimin e një vegle peshkimi tip grackë peshkatari rrethore, në ndërtimin e saj dhe gjuetinë me të, në grykëderdhje lumenjsh.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	102 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Detari”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Nxënësi projektton veglën e peshkimit tip grackë peshkatari rrethore për gjueti në grykëderdhje lumenjsh.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të skicojë veglën e gjuetisë tip grackë peshkatari rrethore;</li><li>- të llogarisë madhësinë e syzës për perden bazë;</li><li>- të llogarisë gjatësinë, ngjyrën dhe fijen e materialit rrjetor;</li><li>- të llogarisë fijen për qepje në litar;</li><li>- të llogarisë koeficientin e rremzhimit dhe lirshmërinë e qepjes në litar;</li><li>- të llogarisë gjatësinë, diametrin dhe llojin e litarëve;</li><li>- të llogarisë sasinë dhe madhësinë e pluskueseve dhe peshave;</li><li>- të llogarisë gjatësinë, madhësinë, formën, mënyrën e qepjes dhe pozicionet e vendosjes së shtyllave të drurit përgjatë veglës së gjuetisë;</li><li>- të llogarisë madhësinë, formën dhe qepjen e panelit rrjetor që do të qëndrojë në tabanin fundor tek dy grackat që shërbejnë për nxjerrjen e peshkut të zënë;</li><li>- të përdorë shenjat dhe simbolet në projektim;</li><li>- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.</li><li>- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenes dhe mbrojtjes nga zjarri.</li><li>- të mirëmbajë vendin e punës.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul>	

## **RM 2 Nxënësi ndërton veglën e peshkimit tip grackë peshkatari rrethore për gjueti në grykëderdhje lumenjsh.**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të llogarisë llojet dhe sasi të materialeve për përdorim sipas projektit;
- të llogarisë madhësinë e syzës së materialit rrjetor, në përputhje me madhësinë e pritshme të peshkut për zënie;
- të llogarisë trashësinë e perit, litarëve, masat e pluskuesave dhe të peshave për ndërtimin e veglës së peshkimit;
- të llogarisë këndin e mundshëm të instalimit të veglës në raport me rrjedhën e ujit të lumit;
- të përzgjedhë materialet e ndërtimit sipas projektit, materialin rrjetor, litarët, pluskuesat, peshat, shyllat mbajtëse të drurit dhe fijet në cilësi, lloj, sasi dhe madhësi;
- të përgatisë veglat dhe ambjentet e punës ku do të ndërtohet vegla e peshkimit, drugën, statikët, ndriçimin, ajrosjen, etj.;
- të presë me thikë materialet sipas gjatësive dhe drejtimit të duhur të tegelit të perdes së rrjetës për të krijuar lirshmërinë e llogaritur;
- të presë me thikë litarët sipas gjatësive të llogaritura;
- të bashkëpunojë hapjen dhe shtrirjen e materialeve për ndërtimin e veglës së peshkimit;
- të realizojë vendosjen e pluskuesave dhe peshave në litarët përkatës;
- të mbushë drugën me fijen e duhur;
- të përdorë drugën për qepjen e rrjetës në litar sipas koeficientit të rremzhimit dhe raportit të lirshmërisë sipas projektit;
- të përdorë teknikën e duhur për kalimin dhe shtrëngimin e fijos në litarët e pluskuesave dhe të peshave;
- të pozicionojë në vendin e duhur pluskuesat dhe peshat gjatë qepjes së materialit rrjetor në litar;
- të realizojë vegat në gjatësinë e llogaritur të litarëve për lidhjen e shtyllave të drurit;
- të realizojë lidhjet e duhura si në litarin e pluskuesave ashtu edhe në atë të peshave në largësitë sipas projektit;
- të realizojë qepjen e paneleve fundore të rrjetave në litarin me pesha që qëndrojnë në tabanin e dy grackave dhe shërbejnë për vjeljen e peshkut të zënë;
- të bëjë kontrolle, herë pas here, në gjatësi të caktuara të qepjes, për deformime nga përpindikularja midis qepjes së materialit rrjetor në litarin e pluskuesave me atë të peshave;
- të raportojë për përfundimin e punës;
- të interpretojë pritshmëritë peshkore nga vegla e përgatitur;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenes dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### **RM 3 Nxënësi instalon për peshkim në bregdet veglën e përgatitur**

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë vendin dhe tabanin e grykëderdhjes së lumit të përshtatshëm për vendosjen e grackës;
- të vlerësojë kushtet e përshtatshme për instalimin e grackës;
- të përgatisë mjetet e punës;
- të përgatisë mjetin pluskues për vendosjen e grackës para instalimit në ujë;
- të vendosë veglën e peshkimit së bashku me peshat, pluskuesat dhe hunjt e drurit në mjetin pluskues pa ngatërresa dhe sipas këndit të llogaritur në raport me rrjedhën e ujit;
- të veshë kostumin prej mushamaje;
- të veshë xhaketën e shpëtimit;
- të lidhë mirë me kavo çeliku shtyllën e parë të drurit me një objekt fiks në breg të lumit;
- të futet në ujë dhe ecë drejt vendit ku do të instalojë grackën duke mbajtur me dorë mjetin pluskues ku e ka vendosur atë;
- të ngulë në thellësinë e duhur shtyllën e parë;
- të mbajë veglën që të mos e marrë uji duke u ndihmuar nga një person i dytë;
- të vijojë sipas projektit dhe kushteve të grykëderdhjes me nguljen e shtyllave të drurit deri tek i fundit duke e shoqëruar me mirë-shtrirjen materialit rrjetor në planin vertikal dhe horizontal;
- të dalë në breg duke mbajtur litarin e shtyllës së fundit të drurit të veglës në dorë;
- të lidhë mirë litarin e hurit të fundit të drurit të veglës së peshkimit me një objekt fiks në krahun tjetër të lumit;
- të nxjerrë nga uji pluskuesen ku ishte vendosur vegla para instalimit në ujë;
- të vendosë në të dy brigjet e lumit dy shtyllat ku do të qëndrojnë krahët për ngritjen e paneleve rrjetore që qëndrojnë në tabanët e dy grackave për vjeljen e peshkut;
- të vendosë mbi shtylla dhe kundrapesha për lehtësi ngritje krahët e paneleve rrjetore që qëndrojnë në tabanët e dy grackave për vjeljen e peshkut;
- të lëshojë brenda zonës së grackave panelet rrjetore që qëndrojnë në tabanët e tyre për vjeljen e peshkut;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

#### **RM 4 Nxënësi mbledh peshkun e zënë nga gracka e peshkatarit të instaluar në grykëderdhjen e një lumi**

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të llogarisë kohën e duhur për lënien e veglës në ujë për peshkim;
- të vlerësojë motin dhe rrjedhën e përshtatshëm për vjeljen e peshkut nga vegla e peshkimit të instaluar;
- të përgatisë mjetet e punës;
- të përgatisë pluskuesin për vendosje të peshkut të zënë;
- të veshë kostumin prej mushamaje;
- të veshë xhaketën e shpëtimit;
- të ngrejë krahun e panelit rrjetor që qëndron në tabanin e grackës së parë për vjeljen e peshkut;
- të rrotullojë krahun me kujdes për nxjerrjen e peshkut të zënë në breg;
- të ecë në ujë, pa zhurmë, duke mbajtur me dorë pluskuesen ku do vendosë peshkun e zënë;
- të bëjë kontrolle me dorë në ujë tek perdja kryesore e veglës për peshq të ngecur në të;
- të heqë me kujdes pa i dëmtuar peshqit e zënë tek vegla e peshkimit;
- të vendosë në pluskuese peshkun e hequr nga vegla duke marrë masa që të mos dalë peshku nga pluskuesja;
- të pastrojë mirë veglën e peshkimit nga papastërtitë e ngecura;
- të kontrollojë palëvizshmërinë e shtyllave të drurit nga vendi i ngulur;
- të dalë në breg me kujdes duke tërhequr pluskuesen me peshkun e zënë të vendosur në të;
- të ngrejë krahun e panelit rrjetor që ndodhet në bregun tjetër të lumit për vjeljen e peshkut të zënë në grackën tjetër;
- të rrotullojë krahun me kujdes për nxjerrjen e peshkut të zënë në breg;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

---

#### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul trajtohet në repartin e riparimit të rrjetave ose laborator shkollor të përshtatshëm dhe në grykëderdhje lumenjsh;
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë, sa më shumë të jetë e mundur, demonstrime konkrete të proceseve për projektimin, ndërtimin dhe realizimin e gjuetisë së peshkut me grackë, në grykëderdhje lumenjsh;
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve përgatitore për projektim, ndërtim dhe realizimin e gjuetisë me vegël peshkimi grackë peshkatarit rrethore në grykëderdhje lumenjsh;

- 
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, në projektimin, ndërtimin dhe realizimin e gjuetisë me vegël peshkimi grackë peshkatari rrethore në grykëderdhje lumenjsh.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- laborator i përshtatshëm shkolle apo repart i riparimi të rrjetave;
  - materiale të nevojshme për ndërtimin e veglës së peshkimit tip grackë peshkatari me dy rrethore për gjueti në grykëderdhje lumenjsh përfshirë material rrjetor, litarë, pluskuesa, pesha, shtylla druri, fije, drugë, statikë, etj.;
  - pajimet përkatëse të gjuetisë me grackë peshkatari rrethore në grykëderdhje lumenjsh;
  - veshjet vetjake të mbijetesës si: xhaketë shpëtimi dhe kostum mushamaje pune;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për ndërtimin e veglës peshkore me grackë peshkatari në grykëderdhje lumenjsh;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për kryerjen e gjuetisë me me grackë peshkatari rrethore në grykëderdhje lumenjsh;
  - mjetet e duhura për sistemimin e peshkur të kapur.
  - materiale të shkruara në mbështetje të realizimit të modulit
-



### 3. Moduli “Lundrim dhe peshkim”

Drejtimi: Detari  
Profili: Teknikë peshkimi  
Niveli: III i KSHK  
Klasa: 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	LUNDRIM DHE PESHKIM	M-16-1677-20
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që aftëson nxënësit për përgatitjen e anijes së peshkimit për lundrim, realizimin e lundrimit të sigurtë në funksion të gjuetisë së peshkut, në përdorimin e pajisjeve dhe mjetet radionavigacionale, në realizimin e procesit të gjuetisë me trata kiçi, në seleksionimin dhe përpunimin paraprak të produkteve të zëna nga gjuetia, në dhënien e asistencës dhe kryerjen e veprimeve të orientuara të thjeshta mirëmbajtëse elektromekanike në sektorin e makinerisë në anije gjatë lundrimit.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	102 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për praninë</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Detari”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Nxënësi asiston në përgatitjen e mjetit për lundrim.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë hartat e duhura dhe të nevojshme për lundrimin e planifikuar sipas udhëzimit të Kapitenit;</li><li>- të bashkëpunojë me Kapitenin për planizimin në hartë të lundrimit, për përcaktimin e kurseve deri në zonën e gjuetisë;</li><li>- të llogarisë rezervat ushqimore, të ujit të pijshëm, hidrokarbure dhe në ambalazh të nevojshëm dhe në sasi të mjaftueshme për gjuetinë e planifikuar</li><li>- të realizojë kontrole paraprake të gjendjes teknike të mjetit të lundrimit lidhur me mjetet Zjarrfikëse, mjetet e shpëtimit, siguria e veglave të gjuetisë (lidhja e sigurtë e tyre), dritat e lundrimit, kontrolli i anës së jashtme të dukshme strukturore të mjetit të lundrimit, etj.</li><li>- të kontrollojë dokumentacionin për lundrim (kontrolli i çertifikatave të flamurit dhe të klasit, çertifikatat e ekuipazhit, kopje roli, lista e ekuipazhit, bashkëpunimi me dispeçerinë e peshkimit për nisjen për lundrim të mjetit;</li><li>- të raportojë tek Kapitenit për konstatimet dhe gatishmërinë</li><li>- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.</li><li>- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenes dhe mbrojtjes nga zjarri.</li><li>- të mirëmbajë vendin e punës.</li></ul>	

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 2 Nxënësi përdor ndihmuesit lundrimor të instaluar në anije për kryrjen e një lundrimi të sigurtë.**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të bashkëpunojë me Kapitenin për organizimin e punës dhe të shërbimit për shmangien e tejlohdhjes;
- të mbajë timonin sipas një komande dhe kursi të dhënë gjatë gjithë kohës së shërbimit;
- të përcaktojë vendodhjen e anijes në hartë me azimute të mara nga objektet bregdetare duke përdorur pelengatorin;
- të përcaktojë shpejtësinë e lëvizjes së anijes me anë të pozicioneve të vendodhjes, duke përdorur logun mekanik dhe me mjete rrethore pluskuese duke bërë matje me kronometër;
- të shfaqë simbolet e REPAD për situatën e mjetit lundrues në gjueti peshku e sipër;
- të monitorojë treguesit e ndryshëm që ndodhen në urën e komandës si të xhirove, timonit, etj.
- Radari:
- të ndezë, ndryshojë kufirin e matjes, ndryshojë fushën e lëvizshme në raport me vijën e besimit të drejtimit të lëvizjes, reduktojë ekot false, rrisë ndjeshmërinë, zmadhojë dhe zvogëlojë intensitetin e ndriçimit të ekranit, përdorë gypin ose strehën hijezuese për përdorim gjatë ditës dhe fikë radarin;
- të përcaktojë vendodhjen e anijes në hartë me azimute dhe largësi të matura nga objektet bregdetare në ekranin e radarit;
- të orientohet për drejtimin e lëvizjes së mjetit lundrues në raport me vijën e besimit, busullën, gps, objekte bregdetare, mjete të tjera lundruese për qark dhe/ose ndihmues lundrimor, etj.
- Eholloti:
- të ndezë, zmadhojë dhe zvogëlojë intensitetin e ndriçimit ose shkrimin (në varësi të llojit të instaluar), reduktojë ekot false dhe rrisë ndjeshmërinë dhe fikë ehollotin;
- të ferifikojë thellësinë e matur nga eholloti duke e krahasuar me thellësinë e hartës në pozicionin e vendodhjes së përcaktuar;
- të identifikojë ekot false dhe të atyre që tregojnë praninë e tufave peshkore, thellësinë në të cilën ndodhen dhe t'ia raportojë Kapitenit.
- Xhirobusulla:
- të ndezë në kohë, kontrollojë nivelin e lëngut pluskues në raport me nivelin e mesit të xhirosferës, të bëjë krahasimë të treguesit të busullës xhiroskopike me atë magnetike ose gps dhe të fikë xhirobusullën;
- Autopiloti:

- të ndezë autopilotin mbas ardhjes në meridian të xhirbusullës, zbatojë procedurat e kalimit nga drejtimi me timonin me dorë në atë me autopilot, raportojë kalimin dhe të fikë autopilotin;
  - NAVTEX:
  - të ndezë, interpretojë mesazhet e mara nga stacionet bregdetare, vendosë letrën e re pas mbarimit të asaj ekzistuese dhe fikë navtex-in.
  - Blue Box:
  - të ndezë, përdorë për transmetimin e të dhënave nga gjuetia dhe të pozicionit të anijes tek stacioni i përcaktuar bregdetar dhe fikë blue-box-in.
  - GPS:
  - të ndezë dhe fikë sipas nevojës gps-në;
  - të interpretojë saktë dhe krahasojë të dhënat e GPS në raport me paisjet e tjera radionavigacionale si radari, busulla, xhirobusulla, etj. si dhe me rrethanat reale si me objektet bregdetare, etj.
  - të përcaktojë vendodhjen e anijes nga të dhënat e mara nga GPS;
  - të krahasojë dhe interpretojë ndryshimet mbi vendodhjen e përcaktuar nga GPS me atë të matur me paisje të tjera si radar, pelengator, etj.
  - Sonari:
  - të përdorë sonarin në mjetet e lundrimit ku është instaluar;
  - të raportojë tek Kapitenit për konstatimet dhe gatishmërinë
  - të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri.
  - të mirëmbajë vendin e punës.
- Instrumentet e vlerësimit:***
- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 3 Nxënësi përdor paisjet e radiokomunikimit detar të zonës A1 të instaluar në anije.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të ndezë radion VHF (very high frequency) të llojit DSC (digital selective call) të instaluar në anije;
- të transmetojë me anë të radios, në frekuencën (kanalin) e përcaktuar siç është:
  - njoftim kapitenerisë për nisje të mjetit lundrues për gjueti;
  - njoftim kapitenerisë për dalje nga porti të mjetit lundrues;
  - raportim të zonës së parashikuar për gjueti;
  - komunikim për siguri trafiku me mjetet e tjera lundruese në lundrim të lirë dhe në situata kur është në gjueti e sipër;
  - komunikim në rastet e operacioneve SAR të kërkim shpëtimit;

- anulim të një alarm të dhënë fals;
- të hedhë shënimet e komunikimit në ditarin e lundrimit;
- të raportojë te Kapiteni për konstatimet, funksionimin e pajisjeve të radios dhe mesazhe të mara nga përgjuesi automatik i frekuencës së avarisë 2182 kHz;
- të mirëmbajë dhe përdorë radiot e dorës të emergjencës përfshirë gatishmërinë e baterive një përdorimshe;
- të raportojë tek Kapitenit për konstatimet dhe gatishmërinë
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 4 Nxënësi merr pjesë në gjuetinë e peshkut me trata kiçi (fundore).**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të veshë mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë
- të përgatisë për hedhje në ujë e veglës së gjuetisë
- të asistojë në teknikën e hedhjes së veglës së gjuetisë në ujë
- të ndjekë procesin e gjuetisë (qëndrim në timon, monitorim);
- të përgatitet për marjen në bord të veglës së gjuetisë nga uji;
- të përdorë mekanizmat e kuvertës për marjen e veglës së gjuetisë në bord
- të asistojë në teknikën e marjes në bord të veglës së gjuetisë nga uji;
- të kryejë riparime të vogla të dëmtimeve të veglës së gjuetisë
- të asistojë në teknikën e ri-hedhjes në ujë të veglës së gjuetisë pas zbrazjes së produkteve të zëna;
- të kryejë në mënyrë të përsëritur veprimet e sipërpërmendura për çdo kalatë gjuetie;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenës dhe mbrojtjes nga zjarri.
- të mirëmbajtje vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 5 Nxënësi mer masat paraprake higjenike për sistemimin e peshkut para dhe pas gjuetisë**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbajë veshur mjetet vetjake të mbrojtjes në punë
- të bashkëpunojë me detar të kualifikuar për punën
- të nxjerë shllangën e ujit të detit nga kutia dhe t'a shtrijë atë gati për përdorim
- të vendosë pipthin e shllangës në saraçineskën e sistemit

zjarrfikës

- të hapë saraçineskën e sistemit zjarrfikës
- të komunikojë me sektorin e makinerisë për gatishmërinë për larje të kuvertës
- të lajë me ujë deti kuvertën ku do të vendoset vegla e gjuetisë dhe peshku
- të nxjerë ambalazhet nga depo dhe t'i vendosë aty ku nuk pengon aktivitetin për marjen e veglës së gjuetisë
- të kontrollojë ambalazhin për dëmtime të mundshme
- të shplajë me ujë deti ambalazhin
- të ri-shplajë kuvertën me ujë deti mbas ri-hedhjes së veglës së gjuetisë në ujë për kalatën e radhës
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjenës dhe mbrojtjes së mjedisit detar në kryerjen e detyrave në kuvertë
- të pastrojë vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje-përgjigje me gojë

**RM 6 Nxënësi kryen përzgjedhjen e peshkut pas gjuetisë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë
- të përzgjedhë peshkun sipas kategorisë, llojit, madhësisë, etj.
- të evidentojë dhe ndajë veçantë peshqit e dyshuar si të sëmurë, të dëmtuar nga vegla e gjuetisë, egërsira, etj.
- të vendosë arkat e ambalazhit pranë kuvertës së kiçit ku ndodhet peshku i zënë
- të përdorë teknikën e duhur për vendosje të peshqve në ambalazh për të shmangur dëmtimet
- të bëjë kujdes nga peshqit helmues dhe dëmtues duke u këshilluar me detarë me përvojë
- të bëjë kujdes nga rrëshqitjet e mundshme në kuvertë duke shmangur kalimin në vende ku ka qenë vendosur peshku apo ka prani vajore
- të bëjë kujdes për të shmangur daljen jashtë bordi në det
- të përdorë akullin për frutat e detit
- të përdorë plastmasin për peshqit me konsistencë mishtore delikate para hedhjes së akullit mbi to
- të përsërisë këtë proces për çdo kalatë gjuetie
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjenës dhe mbrojtjes së mjedisit detar në kryerjen e detyrave në kuvertë
- të pastrojë vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

## **RM 7 Nxënësi vendos peshkun në çelën frigoriferike**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përdorë mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë
- të bashkëpunojë në grup për vendosjen e arkave të ambalazhit me peshk në çelën frigoriferike
- të sigurojë arkat në çelën frigoriferike për të mos u rrëzuar nga lëkundjet e detit
- të zbatojë teknikën e stivimit dhe vendosjes së arkave të ambalazhit në çelën frigoriferike sipas peshëmbajtjes së arkave në lartësi
- të realizojë mbylljen hermetike të çelës frigoriferike
- të vendosë me anë të rregullatorit temperaturën e ruajtjes deri në  $-20^{\circ}\text{C}$
- të monitorojë temperaturën gjatë lundrimit
- të monitorojë punën e kompresorit të frigoriferit gjatë lundrimit
- të raportojë për çdo gjendje normale apo jo-normale të punës së frigoriferit
- të përsërisë këtë proces për çdo kalatë gjuetie
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e shëndetit, sigurisë dhe higjenës gjatë punës në vende me temperatura mjaft të ulta
- të pastrojë vendin e punës.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

## **RM 8 Nxënësi kryen procese të përpunimit paraprak të peshkut**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jenë i aftë:

- të përdorë mjetet mbrojtëse të shëndetit dhe sigurisë në punë
- të përzgjedhë mjetet e punës
- të bashkëpunojë në grup për përgatitjen e një mjedisi sa më higjenik për përpunimin paraprak
- të kryejë pastrimin e peshkut nga pa-pastërtitë e mbledhura bashkë me veglën e gjuetisë
- të ndajë veçantë peshqit e dëmtuar nga vegla e gjuetisë, egërsirat apo të sëmurë
- të realizojë hapjen dhe pastrimin e organeve të brendshme të peshqve me potenciale të mëdha të dekompozimit të brendshëm si peshku pëllumb, peskatriçet, peshqit e familjes së rajave, etj.
- të realizojë me teknikën e duhur shplarjen me ujë deti të peshkut në arkat e ambalazhit para vendosjes së akullit
- të realizojë me teknikën e duhur vendosjen e shtresës së akullit mbi produktet e gjuetisë
- të realizojë teknikën e përdorimit të plastmasit para akullit në peshqit delikatë si barbun, merluc, açuge, etj.

- të realizojë teknikën e duhur vendosjen së arkave të ambalazhit në vende ku nuk rrezikon rrëzimin apo daljen jashtë bordit në det
- të bëjë kujdes për ruajtjen e vetes nga rrëshkitjet në kuvertë apo daljen jashtë bordit në det
- të përsërisë këtë proces për çdo kalatë gjuetie
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjenës dhe mbrojtjes së mjedisit detar në kryerjen e detyrave në kuvertë
- të pastrojë vendin e punës

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 9 Nxënësi mat tanket dhe raporton gjendjen e hidro-karbureve në anije**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë me kujdes dokumentacionin përkatës teknik dhe skemën e tankeve
- të përgatitë vendin e punës për kryerjen e matjes,
- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e duhura të punës sipas teknikës së aplikueshme në mjetin e lundrimit
- të kontrollojë nivelin dhe ndarjet e shiritit matës për rregullsinë e progresit të numerizimit
- të hapë tapën e tankut dhe vendosë atë në vend të sigurtë gjatë matjes
- të përdorë ngjyrues për evidentimin e lagies së shiritit matës në zonën e nivelit të pritshëm për lagje nga hidrokarburi
- të ushtrojë refleksin për të kutptuar prekjen e peshës së shiritit matës në fundin e tankut të naftës
- të ushtrojë refleksin për të kutptuar prekjen e peshës së shiritit matës me sipërfaqen shtresës së mazutit
- të nxjerë me kujdes për të mos shkaktuar ndotje të shiritit dhe leximi i tij
- të llogarisë sasinë e karburantit duke e krahasuar me tabelën e volumeve të tankut për njësi matje
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të raportojë sasinë e hidrokarbureve
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë matjes së tankeve
- të pastrojë vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

Vëzhgim me listë kontrolli

## **RM 10 Nxënësi kryen shërbime ndihmëse në lokalin e makinerisë**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë për ndezje të motogjeneratorit të caktuar
- të realizojë ndezjen e motogjeneratorit
- të realizojë kontrollin e parametrave të punës normale të moto- gjeneratorëve (temp. gazrat, pompë vaji, pompë ftohje, rrjedhje, etj.)
- të realizojë takimin e çelësit për dhënie energjie mekanizmave të ndryshme në kurvetë;
- të kryejë interpretojë parametrat tek paneli elektrik;
- të realizojë prova paraprake pa ngarkesë të mekanizmave në kuvertë nën mbikqyrjen e Kapitenit
- të kryejë prova me ngarkesë të mekanizmave në kuvertë
- të ndjekë punën për kalimin e furnizimit me energji tek mekanizmat nga një moto-gjenerator tek tjetri nëpërmjet metodës së punës në parallel e gjeneratorëve
- të realizojë fikjen e gjeneratorit të caktuar
- të ndezë/fikë pompa të ndryshme elektrike dhe hidraulike
- të ndezë/fikë kompresorët e ajrit dhe realizojë mbushjen e bombolave
- të zmontojë/montojë valvola, saraçineska, tubacione, panjolla dyshemeje, kapakë të depove/tankeve;
- të përgatisë dhe vendosë gomina për izolim të rrjedhjeve në valvola/saraçineska të ndryshme
- të marrë masat e sigurisë ndaj zjarrit në rastet e punimeve me saldim
- të raportojë çdo situatë gjatë kryerjes së shërbimit që i caktohet
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve në lokalin e makinerisë
- të pastrojë vendin e punës.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

## **RM 11 Nxënësi kryen shërbim në lundrim në lokalin e makinerisë**

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të vlerësojë matjen e nivelit dhe gjendjes së ujit të sentinave, të tankeve të ballasteve, të tankeve të mbetjeve vajore, tankeve rezervë, tankeve të ujit të ëmbël, tankeve të ujrave të zeza me atë të raportuar;
- të vlerësojë matjen e nivelit të tankeve rezervë të karburantit, të tankeve të dekantimit, të tankut ditor dhe të tankeve të tjera të mbajtjes së karburantit me atë të raportuar;
- të realizojë shkarkimin ujrave të zeza në det sipas udhëzimit;
- të raportojë gjendjen dhe mënyrën e operimit së sistemeve



- kryesore dhe atyre ndihmuese, përfshirë sistemin e shpërndarjes së energjise elektrike;
- të zbatojë procedurat për mënyrën e operimit në rastet e ndonjë difekti apo të një rrethane të rrezikshme për anijen;
  - të përdorë sistemet e komunikimit të brendshëm;
  - të verifikojë lirshmërinë e rrugëkalimeve të ikjes së emergjencës nga salla mashinës;
  - të kontrollojë me sy sistemet e alarmit të sallës së mashinës.
  - të vlerësojë punën e Moto-Gjeneratorëve
  - të vlerësojë punën e kaldajës
  - të vlerësojë punën e pompës së vajit lubrifikant dhe të oljatorëve të cilindrave të Motorrit Kryesor
  - të vlerësojë punën e pompës së naftës së Motorrit Kryesor dhe spurgot
  - të vlerësojë punën e pompës së ujit ftohës së motorrit kryesor
  - të vlerësojë nëse ka rrjedhje vajore apo shkarkime gazrash
  - të vlerësojë thithjen e ujit të detit dhe qarkullimit për ftohje
  - të vlerësojë nivelin e tubit të vajit hidraulik të sistemit të drejtimit dhe lëvizjes
  - të bëjë kontrollin e punës së turbinës
  - të bëjë kontrollin e punës së valvolave të ndryshme të Motorrit Kryesor dhe motogjeneratorëve
  - të verifikojë gjendjen e mbushjes së bombolave të ajrit
  - të vlerësojë parametrat e punës së motorrit kryesor dhe moto-gjeneratorëve si temperatura, gazrat me atë të raportuar etj.
  - të vlerësojë punën së kompresorit të çelës frigoriferike dhe monitorim të temperaturës me atë të raportuar
  - të raportojë çdo situatë gjatë kryerjes së shërbimit që i caktohet
  - të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së shërbimeve në lokalin e makinerisë
  - të pastrojë vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 12 Nxënësi asiston në planizimin dhe organizimin e punës për kthimin e mjetit të lundrimit në port.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të sigurojë veglat e gjuetisë (lidhja e sigurtë e tyre)
- të përcaktojë kursin për kthim të anijes në port;
- të realizojë detyrat në shërbim si vrojtimi, raportimi, mbajtja e timonit, ditën dhe natën i mbikqyrur periodikisht dhe në kushtet e mjergullës jo pa praninë e një detari të kualifikuar;
- të raportojë objektet dhe dinamikën e tyre, që sheh, dëgjon dhe nuhat nga vëzhgimi përreth/në mjetin lundrues;

- të realizojë një patrullim në mbistrukturë gjatë lundrimit;
- të realizojë me asistencë, hedhjen/ngritjen e spirancës së mjetit lundrues;
- të kryejë shërbim vrojtimi gjatë qëndrimit të anijes në spirancë;
- të identifikojë fenerët dhe ndihmuesit e tjerë detar në bazë të karakteristikave;
- të mbajë shënimet e duhura sipas poroive të Kapitenit;
- të njoftojë menjëherë Kapitenin kur paraqitet një situatë e pazakontë apo kurdo që i është kërkuar të njoftojë;
- të kryejë kontrole të funksionimit dhe temperatures së celës frigoriferike;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri.
- të mirëmbajë vendin e punës

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në anije peshkimi në lundrim.
- Kapiteni ose Krye-Mekaniku, për veprime në lokalin e makinerisë, duhet të përdorin sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete me interpretime të kuptueshme të praktikave të aplikueshme që lidhen me:
  - përdorimin e paisjeve radio-navigacionale për komunikim;
  - gjuetinë e peshkut sipas teknikave të sigurta;
  - përpunimin paraprak dhe ruajtjen e peshkut të zënë;
  - detyra që i caktohen për kryrje në lokalin e makinerisë.
- në funksion të një lundrim të sigurtë dhe eficient të anijes.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të shprehive praktike që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në proceset dhe detyrat para, gjatë dhe në mbërritje nga lundrimi, në gjuetinë e peshkut sipas teknikave përkatëse, në përdorimin e paisjeve radionavigacionale për komunikim detar, në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të përpunimit paraprak të peshkut si dhe kryerjen sipas udhëzimeve të detyrave që i caktohen në lokalin makinerisë së mjetit të lundrimit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Anije e pajisur me të gjitha mjetet dhe pajisjet e duhura për lundrim të sigurtë përfshirë ato radionavigacionale.
-

- 
- Anije peshkimi me veglat e gjuetisë me trata kچی
  - Pajisjet individuale të shpëtimit për të gjithë nxënësit.
  - Mjete pune të përpunimit paraprak të peshkut
  - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarte, manuale dhe skema teknike etj.
  - Materiale të shkruara në mbështetje të trajtimit të modulit.
-

#### 4. Moduli “Rritje artificiale e peshqve”

Drejtimi: Detari  
Profili: Teknikë peshkimi  
Niveli: III i KSHK  
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	RRITJE ARTIFICIALE E PESHQVE	M-16-1678-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të kryer shërbime të ndryshme të karakterit gjysëm i kualifikuar në një fermë/pellg të rritjes artificiale të peshqve	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi kryen plehërimin e pellgut.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë</li><li>- të bashkëpunojë me biologun e fermës për recetat e plehimit, hapat e punës dhe mjetet që do të përdoren</li><li>- të përzgjedhë dhe përgatisë veglat e punës</li><li>- të marrë pjesë në përgatitjen e recetës së plehimit të pellgut me bazë fosforike</li><li>- të marrë pjesë në përgatitjen e recetës së plehimit të pellgut me bazë azotike</li><li>- të marrë pjesë në përgatitjen e recetës së plehimit të pellgut me baze kalcike</li><li>- të mbushë makinën me plehun organik për t’u shpërndarë</li><li>- të shpërndajë plehun organik në të gjithë në argjinaturat ose në bazën e pellgut kur është i tharë</li><li>- të vendosë plehun inorganik në govatat e posaçme dhe në sanallin nga ku do të bëhet shpërndarja në pellg</li><li>- të realizojë me teknikën e duhur shpërndarjen e plehut me bazë fosforike në pellg</li><li>- të realizojë me teknikën e duhur shpërndarjen e plehut me bazë azotike në pellg</li><li>- të realizojë me teknikën e duhur shpërndarjen e plehut me bazë kalcike në pellg</li><li>- të përdorë mjetet lundruese me vozitje ose me shtytje motorrike për kryerjen e shpërndarjes së plehut në pellg</li><li>- të raportojë për realizimin e detyrave të sipërpërmendura</li><li>- të regjistrojë sasinë dhe llojet e plehut të përdorur në</li></ul>	

---

regjistrin e fermës

- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjenës dhe mbrojtjes së mjedisit në fermën e rritjes artificiale të peshkut;
- të pastrojë vendin e punës

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli

## **RM 2 Nxënësi kryen kontrole të ndryshme në pellg/fermë**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të bashkëpunojë me biologun dhe me përgjegjës in e fermës për kontrollet dhe periodicitetin e nevojshëm;
- të përzgjedhë dhe përgatisë veglat e punës;
- të përdorë sanallin me vozitje ose me shtytje motorrike për të bërë kontrole në pellg;
- të realizojë kontrole për peshq të asfiksuar, dëmtuar, sëmurë, etj.;
- të realizojë kontrole për dëmtime të argjinaturave;
- të realizojë kontrollin e prurjes së ujit dhe të qakullimit për oksigjenizimin sa më shumë të masës ujore;
- të evidentojë teknika të ndryshme të matjes së prurjes;
- të marë kampione uji në thellësi të ndryshme për qëllime analizimi;
- të masë temperaturën e ujit në thellësi të ndryshme të pellgut;
- të llogarisë përqindjen e oksigjenit të tretur në ujë nga kampionët e ujit të marë;
- të kryejë vëzhgime të nivelit të fitoplanktonit në pellg sipas praktikës së aplikuar në pellg;
- të kryejë pastrime të kanaleve të prurjes dhe shkarkimit të ujrave;
- të realizojë me teknikën e aplikuar në fermë për hapjen e prurjes dhe shkarkimit për qarkullim dhe oksigjenizim të ujit në rastet e ngritjes së temperaturave në pellg;
- të punojë në grup për transferimin e rasatëve nga njëri pellg në një tjetër sipas stadeve të rritjes apo arsye të tjera
- të marë pjesë në grup për marjen e individëve të përshtatshëm për shtim artificial dhe injektimin e hipofizës
- të raportojë për realizimin e detyrave të sipërpërmendura;
- të regjistrojë matjet, analizat dhe gjetjet gjatë kontrolleve në regjistrin e fermës;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjenës e mbrojtjes së mjedisit në fermën e rritjes artificiale të peshkut;
- të pastrojë vendin e punës

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli

### **RM 3 Nxënësi kryen shpërndarjen e ushqimit të peshqve**

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të bashkëpunojë me biologun dhe me përgjegjësin e fermës për kontrollet dhe periodicitetin e nevojshëm;
- të përzgjedhë dhe përgatisë veglat e punës;
- të vendosë me kujdes dhe sigurojë bazën ushqimore në sanall/mjetin e shpërndarjes;
- të vozisë sanallin me ushqimin e peshqve sipas mënyrës së udhëzuar nga biologu i fermës;
- të vlerësojë gjendjen e pranisë së fitoplanktonit në pellg si ushqim për peshqit;
- të realizojë me teknikën e duhur shpërndarjes së ushqimit gradualisht duke e hedhur në pellgun e peshkut me mjetet e duhura;
- të evidentojë teknikat e ndryshme të shpërndarjes së ushqimit sipas llojit të peshkut dhe fazës së rritjes;
- të vlerësojë reagimet e para për gjendjen shëndetsore të peshkut në bazë të dëshirës për marjen e ushqimit;
- të raportojë për realizimin e detyrave të sipërpërmendura;
- të regjistrojë matjet, analizat dhe gjetjet gjatë kontrolleve në regjistrin e fermës;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjenës e mbrojtjes së mjedisit në fermën e rritjes artificiale të peshkut;
- të pastrojë vendin e punës;

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### **RM 4 Nxënësi asiston në gjuetinë e peshkut me trata krahu në fermën e rritjes artificiale të peshkut**

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të bashkëpunojë me biologun dhe me përgjegjësin e fermës për procesin e gjuetisë në pellg;
- të përzgjedhë dhe përgatisë veglat e punës;
- të përgatisë arkat e ambalazhit për vendosjen e peshkut;
- të marrë pjesë në grup për tërheqjen me krahë të tratës për gjatë pellgut deri sa të dalë thesi në breg;
- të përdorë çupallën (koshin e dorës) për mbledhje peshku nga thesi i tratës dhe përcjellje dorazi për vendosje në arka;
- të shplajë peshkun me ujë nga balta e pellgut;
- të kryejë zbrazjen e peshkut për seleksionim në ambientet

- e një sheshi të pastër betoni të fermës;
- të kryejë përzgjedhjen dhe vendosjen e peshkut sipas llojit dhe kategorisë në arkat e ambalazhit;
- të shplajë me ujë të pastër peshkun dhe t'a peshojë;
- të asistojë për vendosjen e arkakave të mbushura me peshk në automjetin frigorifer që dërgohet për treg për konsum;
- të kryejë veçimin e disa individëve për kampionim për vlerësim të rritjes;
- të raportojë për realizimin e detyrave të sipërpërmendura;
- të regjistrojë matjet, analizat dhe gjetjet gjatë kontrolleve në regjistrin e fermës;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjenes dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë gjuetisë në pellg dhe në fermën e rritjes artificiale të peshkut;
- të pastrojë vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 5 Nxënësi kryen matje të treguesve meristemo-somatikë të peshqve**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të bashkëpunojë me biologun për kategorinë e individëve që do të kampionohen;
- të bashkëpunojë me përgjegjësin e fermës për hapat e punës
- të përzgjedhë dhe përgatisë veglat e punës;
- të përgatisë vendin e punës për kampionim;
- të përdorë sanallin për të marë kampione peshku në vaska të ndryshme;
- të përdorë me teknikën e duhur koshin e dorës/çupallën për marjen e kampioneve;
- të përzgjedhë kampionët sipas udhëzimeve të biologut;
- të mbajë shënime operative për vendet e marjes së kampioneve duke i vendosur përkatësisht në vende të ndryshme në sanall;
- të lajë individët për kampionim;
- të masë saktë peshën e peshqve të kampionuar;
- të masë gjatësinë e kampionit me kalibër/vizore;
- të masë gjatësinë industriale të kampionit;
- të masë gjatësinë e kokës së kampionit;
- të masë elementë të tjerë si gjatësia preorbitale, postorbitale, diametri i syrit, gjatësia e pendës së parë dhe të dytë shpinore, të pendës gjoksore, gjatësia e trungut të trupit, të trungut të bishtit, lartësia e trupit, etj.;
- të marë kampione të luspave nga pozicionet e caktuara të trupit të peshkut për kampionim;
- të bëjë krahasime hulumtuese të moshës së llogaritur me

- anë të luspave me atë sipas regjistrave të fermës;
- të raportoje tek biologu për hapat e ndjekur dhe gjetjet;
- të hedhë të dhënat nga matjet dhe vlerësimi me pamje në regjistrin përkatës për efekte monitorimi të elementëve të rritjes;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjenës e mbrojtjes së mjedisit në fermën e rritjes artificiale të peshkut;
- të pastrojë vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në sektorë të ndryshëm të rritjes së peshkut në mënyrë artificiale dhe në laboratorin e akuakulturës dhe peshkimit. Rekomandohet të mbahen kontakte me ekonomi të rritjes didaktike ose me ekonominë të rritjes artificiale për të bashkërenduar kohën e përshtatshme të kryerjes së praktikave në përputhje me planin e punës që ekonomisë.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete të proceseve të ndryshme që kanë të bëjnë me rritjen e artificiale të peshqve dhe shërbimet e caktuara që i bëhen në pellg/fermën e rritjes artificiale.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të njohurive që trajton moduli.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në realizimin e matjeve dhe kontrolleve të ndryshme për qëllime studimore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- pellg ose fermë e rritjes artificiale në ujra të ëmbla, njelmëta, në bregdet ose në laboratorin e akuakulturës dhe peshkimit.
  - aparate matëse dhe kontrollues të temperaturës, kalibër, peshore, etj. të disponueshme në laborator.
  - pankarta, makete, udhëzues, katalogë, rregullore, standarte, manuale teknike etj.
  - materiale të shkruara në mbështetje të realizimit të modulit
-



## X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

### 1. Moduli “Shërbime në veglat e peshkimit”

Drejtimi: Detari  
Profili: Teknikë peshkimi  
Niveli: III i KSHK  
Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHËRBIME NË VEGLAT E PESHKIMIT	M-16-1679-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të kryer shërbime mirëmbajtëse, riparuese dhe në funksion të ruajtjes së jetëgjatësisë së veglave të peshkimit pas gjuetie.	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Detari”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi kryen punime riparimi të veglave të peshkimit të dëmtuara nga gjuetia.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë <ul style="list-style-type: none"><li>- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;</li><li>- të përzgjedhë mjeteve të punës;</li><li>- të kryejë riparime të thjeshta të dëmtimeve të pëlhurës në litarin e pluskuesve;</li><li>- të kryejë riparime të thjeshta të dëmtimeve të pëlhurës në litarin e peshave;</li><li>- të kryejë riparime të thjeshta të dëmtimeve në pëlhurën e thesit;</li><li>- të realizojë mbushje me syza të dëmtimeve në vende të ndryshme të tratës;</li><li>- të realizojë arnime me pëlhurë të ngjashme të zonave të dëmtuara në tratë;</li><li>- të kryejë zëvendësime dhe lidhje në litar të pluskuesve të dëmtuar;</li><li>- të realizojë përforcime të zonave të dobësuar në pëlhurë dhe litarë të veglës së gjuetisë;</li><li>- të kryejë zëvendësime të gadinave të dëmtuara në timonët e tratës;</li><li>- të kryejë riparime të pjesëve të dëmtuara të timonëve të</li></ul>	

---

tratës;

- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli

## **RM 2 Nxënësi kryen shërbime për ruajtjen e jetëgjatësisë së veglave të peshkimit**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të përzgjedhë mjeteve të punës;
- të sigurohet për ambjentin e sigurtë të punës, pa pengesa, vajra rrëshkitës, mbetje të peshkut, vegla, etj.
- të punojë në grup për të shpalosur veglën e peshkimit me qëllim pastrimi dhe identifikim dëmtimesh;
- të vendin për stivim të veglës pas pastrimit;
- të pastrojë veglën e peshkimit nga mbetjet e ndryshme;
- të identifikojë dëmtimet e mundshme;
- të ndajë veç dhe shenjëzojë vendet e dëmtuara për riparim; të shplajë me ujë të ëmbël veglën e peshkimit;
- të mbulojë me mbulesën e caktuar, veglën e peshkimit për t'a ruajtur nga rrezatimi diellor;
- të sigurojë me lidhje apo tjetër sipas rastit, veglën e peshkimit dhe pjesët përbërëse të saj, për të mos u dëmtuar nga lëkundjet e anijes në lundrim;
- të raportojë gjetjet tek kapiteni;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli

## **RM 3 Nxënësi kryen sistemimin e kavove të tratës së kjiçit pas gjuetie në kalatë**

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të përzgjedhë mjeteve të punës;
- të sigurohet për zonën ku do të shtrihen kavot për balancim dhe kontroll;
- të lidhë mirë të dy fundet e kavove në një mjet lëvizës;
- të bashkërendojë me operatorin e vinçit të tratës për të filluar lëshimin, për të ndaluar dhe mbledhur kavon në përfundim të procesit;

- të lëvizë mjetin ku janë kapur kavot me qëllim shtrirjen e tyre në drejtimin e caktuar;
- të kryejë lëvizjet dhe ndalimin e mjetit ku janë kapur kavot duke u bashkërenduar me operatorin e vinçit të tratës;
- të kontrollojë për dëmtime të mundshme të kavove;
- të komunikojë me operatorin e vinçit të tratës për të mbledhur ndonjëerën nga kavot me qëllim balancimin e gjatësive;
- të kryejë grasatimin e kavos para mbledhjes në tamburot e vinçit;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe etikë profesionale
- të zbatojë rregullat sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në një anije peshkimi që sapo ka ardhur nga gjuetia.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete të proceseve të ndryshme që kanë të bëjnë masat mbrojtëse në punë dhe nga zjarri për kryerjen e shërbimeve për ruajtjen e jetëgjatësisë së veglës së peshkimit, kryerjen e riparimeve dhe shtrirjen e kavove për balancim.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për kryerjen e punimeve të ndryshme për kryerjen e shërbimeve për ruajtjen e jetëgjatësisë së veglës së peshkimit, kryerjen e riparimeve dhe shtrirjen e kavove për balancim.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet si më poshtë:
- anije peshkimi e sapo ardhur nga gjuetia në det;
  - vegla dhe instrumenta pune të disponueshme për kryerjen e shërbimeve për ruajtjen e jetëgjatësisë së veglës së peshkimit, kryerjen e riparimeve dhe shtrirjen e kavove për balancim të dokim riparimit të mjetit të lundrimit prej druri dhe metalik.
  - vendi ku do të kryhen punimet e mirëmbajtjes-riparimit.
  - udhëzues, katalogë, rregullore, standarde, manuale teknike etj.
  - materiale të shkruara në mbështetje të realizimit të modulit
-

## 2. Moduli “Teknika e peshkimit tip tratë krahu”

**Drejtimi:** Detari  
**Profili:** Teknikë peshkimi  
**Niveli:** III i KSHK  
**Klasa:** 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	TEKNIKA E PESHKIMIT TIP TRATË KRAHU	M-16-1680-20
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që aftëson nxënësit të marrë pjesë aktive në projektimin, ndërtimin dhe kryerjen e procesit të gjuetisë në ujra të cekëta me tratë krahu.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	102 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për praninë</b>	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin II të KSHK në drejtimin mësimor “Detari”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Nxënësi projektton një vegël peshkimi tip tratë krahu për gjueti në ujra të cekëta.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të skicojë veglën e peshkimit tip tratë krahu për gjueti në ujra të cekëta;</li><li>- të llogarisë madhësinë e syzës për panelin bazë, shoqërueset dhe thesin;</li><li>- të llogarisë gjatësinë, ngjyrën dhe fijen e materialit rrjetor;</li><li>- të llogarisë fijen për qepje në litar;</li><li>- të llogarisë koeficientin e rremzhimit, lirshmërinë e qepjes në litar për të gjithë panelet rrjetore;</li><li>- të llogarisë gjatësinë, diametrin dhe llojin e litarëve;</li><li>- të llogarisë sasinë dhe madhësinë e pluskueseve dhe peshave;</li><li>- të llogarisë peshën e përgjithshme të veglës së peshkimit;</li><li>- të përdorë shenjat dhe simbolet në projektim;</li><li>- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.</li><li>- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenes dhe mbrojtjes nga zjarri.</li><li>- të mirëmbajë vendin e punës.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul>	
	<p><b>RM 2 Nxënësi ndërton veglën e peshkimi tip tratë krahu për gjueti në ujra të cekëta.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përzgjedhë materialet e ndërtimit sipas projektit, materialin rrjetor, litarët, pluskuesat, peshat dhe fijet në cilësi e lloj;</li></ul>	

- të llogarisë sasinë e materialeve për përdorim sipas projektit;
- të përgatisë veglat dhe ambjentet e punës ku do të ndërtohet vegla e peshkimit, drugën, statikët, ndriçimin, ajrosjen, etj.;
- të presë me thikë materialet e përzgjedhura sipas gjatësive të llogaritura për të gjithë panelet e rrjetës të veglës së peshkimit dhe litarëve;
- të bashkëpunojë hapjen dhe shtrirjen e materialeve për ndërtimin e veglës së peshkimit;
- të realizojë vendosjen e pluskuesave dhe peshave në litarët përkatës;
- të mbushë drugën me fijen e duhur për qepjet në litar dhe ndërmjet paneleve rrjetore;
- të përdorë drugën për qepjen e rrjetës në litar për çdo panel rrjete sipas koeficientit të remzhimit dhe raportit të lirshmërisë sipas projektit;
- të përdorë teknikën e duhur për kalimin dhe shtrëngimin e fijes në litar;
- të pozicionojë në vendin e duhur pluskuesat dhe peshat gjatë qepjes së materialit rrjetor në litar;
- të bëjë kontrolle, herë pas here, në gjatësi të caktuara të qepjes, për deformime nga përpindikularja midis qepjes së materialit rrjetor në litarin e pluskuesave me atë të peshave;
- të qepë sipas koeficientit të caktuar në litarët e pluskuesave dhe atë të peshave, perdet e dyta dhe të treta të veglës;
- të vendosë pluskuesat dhe peshat fundore sipas projektit;
- të raportojë për përfundimin e punës;
- të interpretojë pritshmëritë peshkore nga vegla e përgatitur;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, ruajtjes së mjedisit detar, higjenes dhe mbrojtjes nga zjarri;
- të mirëmbajë vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

**RM 4 Nxënësi asiston në gjuetinë e peshkut me trata krahu në një fermë peshku**

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbajë veshur mjetet e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë;
- të bashkëpunojë me biologun dhe me përgjegjësin e fermës për procesin e gjuetisë në pellg;
- të përzgjedhë dhe përgatisë veglat e punës;
- të përgatisë arkat e ambalazhit për vendosjen e peshkut;
- të marrë pjesë në grup për tërheqjen me krahe të tratës për gjatë pellgut deri sa të dalë thesi në breg;
- të përdorë çupallën (koshin e dorës) për mbledhje peshku nga thesi i tratës dhe përcjellje dorazi për vendosje në arka;
- të shplajë peshkun me ujë nga balta e pellgut;
- të kryejë zbrazjen e peshkut për seleksionim në ambjentet e

- një sheshi të pastër betoni të fermës;
- të kryejë përzgjedhjen dhe vendosjen e peshkut sipas llojit dhe kategorisë në arkat e ambalazhit;
- të shplajë me ujë të pastër peshkun dhe t'a peshojë;
- të asistojë për vendosjen e arkakave të mbushura me peshk në automjetin frigorifer që dërgohet për treg për konsum;
- të kryejë veçimin e disa individëve për kampionim për vlerësim të rritjes;
- të raportojë për realizimin e detyrave të sipërpërmendura;
- të regjistrojë matjet, analizat dhe gjetjet gjatë kontrolleve në regjistrin e fermës;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik, higjenës dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë gjuetisë në pellg dhe në fermën e rritjes artificiale të peshkut;
- të pastrojë vendin e punës

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në liqene ose ujëmbledhës;
- Kapiteni/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve që zbatohen në gjuetinë e peshkut sipas teknikës së mësipërme.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të shprehive praktike që trajton moduli, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Gjithashtu ata duhet të angazhohen në përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në proceset e gjuetisë së peshkut me teknikat e sipërpërmendura.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:
- laborator i përshtatshëm shkolle apo repart riparimi rrjetash;
  - materiale të nevojshme për ndërtimin e veglës së peshkimit tip tratë krahu për gjueti në ujra të cekëta përfshirë material rrjetor, litarë, pluskuesa, pesha, fije, drugë, statikë, etj.;
  - pajimet përkatëse të gjuetisë me tratë krahu në liqene;
  - veshjet vetjake të mbijetesës si: xhaketë shpëtimi dhe kostum mushamaje pune;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për ndërtimin e veglës peshkore tip tratë krahu për jueti në ujra të cekëta;
  - tabelë udhëzuese të hapave të punës për kryerjen e gjuetisë tip tratë krahu për jueti në ujra të cekëta;
  - Mjetet e duhura për sistemimin e peshkur të kapur.
  - materiale të shkruara në mbështetje të realizimit të moduli
-

---

<sup>i</sup> Konventa e Standarteve të Trajnimit, Çertifikimit dhe Shërbimit për Detarët e vitit 1978, e ndryshuar  
<sup>ii</sup> Konventa e Standarteve të Trajnimit, Çertifikimit dhe Shërbimit për Detarët e vitit 1978, e ndryshuar